

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it, në bashkëpunim me studentë të degëve të ndryshme, si dhe me specialisten e Marrëdhënieve me Publikun, zhvilluan një trajnim me temë: "Rrjetet sociale dhe ndikimi i tyre: avantazhet dhe disavantazhet".

Trajnimi kishte për qëllim të analizojë ndikimin e rrjeteve sociale në përditshmërinë tonë, si dhe të informojë studentët mbi mënyrat se si ato mund të shfrytëzohen në mënyrë të dobishme, duke evidentuar gjithashtu mundësitë e punësimit në fushën e menaxhimit të rrjeteve sociale.

Në këtë trajnim do të trajtohen temat:

- Roli i rrjeteve sociale në shoqërinë bashkëkohore
- Ndikimi i rrjeteve sociale në komunikim dhe informim
- Avantazhet e përdorimit të rrjeteve sociale
- Disavantazhet dhe rreziqet e përdorimit të pakontrolluar të rrjeteve sociale
- Ndikimi i rrjeteve sociale në shëndetin mendor dhe mirëqenien personale
- Mundësitë e punësimit dhe orientimit drejt profesionit të menaxherit të rrjeteve sociale

